

H Y L L I I D R I T Ë S

E PËRKOHSHME KULTURALE - LETRARE

Editorial <i>Në shërbim të kulturës shqiptare</i>	3
Bardhyl Demiraj <i>Grimca biografike për autorët tanë të vjetër</i> <i>I. Frang Mark Bardhi (1606 – 1643)</i>	7
Evalda Paci <i>Një traditë studimesh dhe botimesh mbi Fjalorin latinisht-shqip</i> <i>të Frang Bardhit(1635)</i>	16
David Luka <i>Fjalorth i fjalëve të rralla në veprën “Anzat e Parnasit”</i> <i>të Gjergj Fishtës</i>	28
Gjovalin Çuni - Fatmira Lekiqi <i>Gjurmë të At’ Gjergj Fishtës në Bibliotekën Publike “Marin Barleti”</i>	64
Willy Kamsi <i>Autorë dhe botime Arbëreshe në Bibliotekën e Universitetit</i> <i>«Luigj Gurakuqi» të Shkodrës</i>	76
Arben Prendi <i>Mbi disa dukuri të kompleksitetit stilistik dhe semantik</i> <i>të tekstit poetik të M. Camajt</i>	86
Alfred Çapaliku <i>Konica për Gjeçovin</i>	115

Bardhyl Demiraj <i>Fé dhe Të prémt e fés në Kanunin e Lekë Dukagjinit</i>	120
<i>Brilante biblike të Át Daniel Gjeçaj, OFM</i>	148
Át Daniel Gjeçaj, OFM <i>Kanga e kangëve</i>	149
Anza Shkodra <i>Busti</i>	162
BOTIME TË REJA - REÇENSIONE	165
ARKIVI I HYLLIT	
Át Benedikt Dema, OFM <i>Fjalori historik - gjeografik – mytologjik i “Lahutes së Malcís”</i>	169
Át Gjergj Fishta, OFM <i>Kërkesë për restaurimin e Kishës së Lezhës (Letër)</i>	204

Grimca biografike për autorët tanë të vjetër I. Frang Mark Bardhi (1606 – 1643)

Vëzhgime hyrëse

Në botimin e dikurshëm kritik të *Dictionarium latino – epiroticum* me autor Frang Bardhin (= lat. <Franciscus Blanc(h)us> – B.D.) shkruesi i këtyre radhëve i bëri fillimisht të njohur lexuesit në një shënim hyrës se studimet e derisotme mbi jetën, formimin dhe veprimtarinë e tij fetare-intelektuale mbështeteshin kryekëput në atë material biobibliografik që mbledhi gjatë hulumtimeve të veta arkivore, historike dhe bibliotekare deri në vitet 30' të shekullit të kaluar murgu filolog me origjinë franceze Mario Roques (= shq. /Mario Rok/). Këtë material Roques e sistematizoi dhe sythoi atëbotë sa dhe siç duhej në parathënien e botimit të parë anastatik të Fjalorit.¹ E meqë këtë material nuk kishim mundur ta plotësonim me ndonjë të dhënë të re dokumentare, parapëlqyem t'i përcillnim lexuesit në botimin tonë kritik pikërisht atë hyrje, parë kjo edhe si shenjë homazhi për mjeshtrin e madh filolog, të cilin vazhdojmë ta rinjohim e rizbulojmë ende sot e gjithë ditën. Për më tepër këtë homazh kishte mundur ta sendërtonte shqip më parë penda dhe puna si gjithherë e panjollë e Willy Kamsit (W. K.), të cilit shfrytëzuam rastin në atë shënim t'i shprehim mirënjohjen tonë të thellë që na lejoi të ngërthejmë në atë botim bash përkthimin e tij me një gegnishte letrare elegante, të publikuar për herë të parë në Buletinin e Institutit Dyvjeçar të Shkodrës (1964).²

Në rast se lejohehi tash të përmbledhim thukët rezultatet e studimit të Mario Roques në hyrje të ribotimit anastatik të atij fjalori, vërejmë së pari që ai mbështetet – përpos të dhënave biografike që përcjell ndonjë kompendium enciklopedik i kohës³ edhe në sosh autobiografike që i kumton vetë Bardhi në dy vepra të vetat⁴ – sikurse edhe në një material

¹ ROQUES 1932a 22vv.

² Shih DEMIRAJ 2008 9/*.

³ Khs. ndër të tjerë FARLATI & COLETTI 1817 285vv.

⁴ Khs.: a) *Dictionarium latino – epiroticum. Una cum nonnullis usitatoribus loquendi formulis.* Per R. D. Franciscum Blanchum Epirotam Coll. de Propag. Fide Alumnum. Romæ, Typis Sac. Congr. de Propag. Fide. 1635; dhe b) *Georgius Castriottus, Epiroensis vulgò Scanderbegh, Epirotarum princeps fortissimus, ac iniuctissimus Suis, & Patriae restitutus.* Per Franciscum Blancum. De Alumnis, Collegij de Propaganda Fide, Episcopum Sappatensem

dokumentar, sado të rrudhur e të shpërndarë në dosjet e shumta të Arkivit Historik të Propaganda Fide-s, sikurse dhe në Bibliotekën Apostolike të Vatikanit. Falë seleksionimit dhe sistematizimit të gjithë atij materiali ai mundi gjithsesi të rindërtojë një numër stacionesh në jetën, aktivitetin fetar dhe angazhimin intelektual sado jetëshkurtër (në jo më shumë se 37 vjet) të Frangut tonë, të cilin gëzojmë ne sot të drejtën ta mirënjohim si gurëvënës in e debatit intelektual albanologjik dhe të mendimit shkencor-historik shqiptar.

Ndër ato stacione jetësore të Frang Bardhit që Mario Roques arrin të rindërtojë me siguri relative mësojmë sidomos për periudhën para fillimit të aktivitetit të tij baritor si ipeshkëv i Dioqezës së Sapës dhe Sardës (mars 1636), ndër të tjera:

- a) Vendlindjen e Frang Bardhit në zonën e Zadrimës, të cilën vetë Bardhi e mëton në parathënien e apologjisë së tij mbi Skënderbeun, si: “Pars Sadrimæ patriæ meæ”;
- b) Vitin 1606 si vitlindje e Frang Bardhit, të cilin Roques e përlllogarit në bazë të të dhënave që fiton prej informacionit bibliografik (Farlati & Coleti VII 285vv.) sikurse edhe prej leximit të breves së dt. 17 dhjetor 1635, me të cilën Papë Urbani VIII emëron Frang Bardhin si ipeshkëv i Dioqezës (së bashkuar) të Sapës dhe Sardës dhe administrator apostolik i zonës së Pultit.
- c) Kolegjin Ilirik të Loreto-s, ku Frang bardhi nisi fillimisht studimet falë ndërhyrjes së suksesshme të ungjit të tij Gjec Bardhit (= lat. <Georgio Blanchus> – B.D.), duke fituar me përfundimin e tyre, pas gjase të suksesshëm, edhe statusin e diakonit.
- d) Kolegjin Urban të Propaganda Fide-s në Romë, ku regjistrohet më dt. 12 qershor, duke plotësuar aty studimet e tij në teologji dhe duke u shuguruar së fundi prift dikur ndërmjet datave 19 mars deri 30 maj 1635: data e dytë do marrë, sipas Roques, si cak *post quem non*, meqë me të shoqëron edhe nënshkrimin në parathënien e fjalorit të vet me shqipërimin e variantit gjithsesi të latinizuar të emrit të vet: /D[on] Frangu i Bardhë/ (= <D. Frangu i Barçe> = lat. <Franciscus Blanchus> – B.D.).
- e) Kuntin për firmosjen më dt. 1 shtator 1635 të atij betimi, i cili u kërkohej normalisht të gjithë nxënësve të Kolegjit Urban me u zotuar se do t’i dërgonin çdo vit Kongregatës së Shenjtë të Propagandës një relacion të detajuar lidhur me mbarëvajtjen e grigjës e përgjithësisht të jetës fetare në famullitë e dioqezat e vendlindjes, ku do të vepronin si klerikë; e së fundi edhe

& Sardanensem, necnon Pulatensium, aliorumque Albaniae Populorum Administratorem. – Venetiis. Typis Marci Ginammi. MDCXXXVI.

f) kumtin se bash ditën e diel më dt. 30 mars 1636 Frang Bardhi u shugurua ipeshkëv i Dioqezës së Sapës dhe Sardës, duke marrë më dt. 8 [sic! – shën. 14] prill të atij viti udhën drejt Venecias e për të vazhduar më pas që andej udhëtimin për në vendlindje.

Lejohemi t'i mbyllim këtu këto vëzhgime paraprake mbi Frang Bardhin, duke shtuar së fundi që Mario Roques ka shfrytëzuar – sidomos për tri pikat e fundit: d), e) dhe f) – si burim arkivor të dorës së parë një material në dorëshkrim, të hartuar dhe nënshkruar në dhjetor të vitit 1636 nga vetë rektori i Kolegjit Urban, në të cilin është dhënë informacion për të gjithë rishtarët që studionin në atë kolegji prej vitit 1633 (– 1936).⁵

* * *

Në këtë shkrim tejet modest jemi përqendruar vetëm në periudhën e edukimit fetar-intelektual të Frang Bardhit në Kolegjin Ilirik në Loreto dhe në Kolegjin Urban në Romë, pra në periudhën para fillimit të aktivitetit të tij baritor në vendlindje, meqë pikërisht me këtë periudhë lidhen në një mënyrë a një tjetër edhe ato të dhëna të reja në formë grimcash biografike, që kemi mundur t'i qëmtojmë për personin e tij gjatë kërkimeve tona të fundit në Archivio Romano della Società di Gesù (ARSI – Romë, mars 2015), Archivio Storico della Sacra Casa (ASSC – Loreto, maj 2015) si edhe në Archivio del Collegio Urbano (ACU – Romë, shtator 2015), si tri stacione pune në realizimin e projektit tonë afatgjatë që ka të bëjë me rindërtimin e rrjetit të formimit arsimor-fetar dhe të nivelit të diskursit intelektual në arealin kulturor shqiptar të Veriut gjatë shek. XVII-XVIII deri në gjysmën e parë të shek. XIX. Shtojmë së fundi që këto tri vatra dokumentimi arkivor pas gjase nuk duket të jenë konsultuar dikur prej Mario Roques në kërkimet e tij, andaj edhe rezultatet e kërkimeve tona duan parë sipas rastit si plotësim dhe/ose verifikim i rezultateve në shumësinë e tyre solide, të arritura prej tij këtu e tetë dekada më parë.

1. Frang Bardhi, biri i Markut – nëndiakon në Kolegjin Ilirik të Loreto-s

Në ARSI ndodhet i depozituar regjistri i betimeve në Kolegjin Ilirik të Loreto-s⁶ si procedurë kjo e detyrueshme për të gjithë ata rishtarë që kishin përfunduar me sukses fazën përgatitore të formimit meshtarak

⁵ ROQUES 1932a 23/shën. 2: “Bibl. Vaticane, ms. Barberini lat 4447: *Compendio cronologico del Collegio Urbano de Propaganda Fide... fatto da Bernardino Larizza Sacerdote di San Girolamo della Carità di Roma*. Le *Compendio* est de décembre 1636; le rédacteur était recteur du Collège.”

⁶ ARSI Rom 229: Liber in quo habentur Nomina Alumnorum qui in Coll.o Illyrico Laurentano praestiterunt Juramentu. Ab Anno D.ni MDCXXVIII & Princeps & nomina rectori Collegii.s.

e tashmë duhej të zotoheshin në prani të rektorit të kolegjit dhe dy rishtarëve të tjerë si dëshmitarë okularë që pas mbarimit të studimeve do të ktheheshin në vendlindje, duke iu bindur me besnikëri urdhrit dhe detyrave që u caktonte ipeshkvi i dioqezës përkatëse. Në fol. 3v të këtij regjistri lexojmë regjistrimin e bërë ashtu shkarazi e me një bukurshkrim që lë vetëm për të dëshiruar, sa vijon:

<[...] et die 15 eiusdem Mensis [= Aprilis – B.D.] et Anni [= MDCXXIX – B.D.]

Franciscus Marci Blanci, Diec[esi] Sappaten[sis]> (fol. 3v)⁷

Shqip: "... më 15 të të njëjtit muaj dhe vit: Frang Mark Bardhi, Dioqeza e Sapës."

Në këtë regjistrim bie në sy, përpos dioqezës së atëhershme (së Sapës) nga vinte si edhe datës së betimit të tij më 15 prill 1629 si rishtar i Kolegjit Ilirik të Loreto-s, edhe atësia e Frang Bardhit si i biri i Markut. Plotësojmë me këtë rast, ndër të tjera, një boshllëk në lisin e gjakut të derës së Bardhenjvet, si fis i njohur i Zadrimës që ka nxjerrë në vazhdimësi një numër të madh klerikësh katolikë.⁸

2. Rishtar dhe diakon në Kolegjin Ilirik të Loreto-s

Në një tjetër dokument që ndodhet i depozituar në ASSC⁹ mësojmë që Frang Bardhi ishte regjistruar në Kolegjin Ilirik të Loreto-s nëntë muaj para betimit, shi më dt. 22 korrik 1628, duke pasur si i tillë statusin e nëndiakonit, çka vjen me thënë se kishte mundur të merrte qysh në vendlindje një formim paraprak shkollor.¹⁰ Në këtë kolegji që drejtohej atëbotë prej etërve jezuitë, Frangu ynë iu nënshtrua për thujtë pesë vjet programit të mirënjohur akademik "Ratio studiorum"¹¹, për të marrë më pas, më dt. 15 maj 1633, rrugën drejt Romës e me vijuar aty, në Kolegjin Urban të Propaganda Fide-s, studimet për teologji skolastike. Kështu, në këtë dokument lexojmë, ndër të tjera:

<Francesco Bianchi da Sadrina d'Albania entrò in Coll.º Ill.

º Subdiacono à 22 di 7bre 1628 d'anni 22. Parti li 15 di Mag. 1633, per entrar del nuovo Coll.º de propag. Fide in Roma d'ordine della S. Congregatione de propaganda per studiar Theologie Scholastica.>¹²

7 Sqarim: në fund të fol 3r kemi regjistrimin paraprijës të betimit të radhës, të bërë më dt. 8 prill 1629.

8 Bardhi citon në parathënien e fjalorit të vet Gjec Bardhin (IIIv = <Georgio Blancus> – B.D.). Shih më hollësisht Roques 1932a 20vv.

9 ASSC Tit. 30-32. fol. 1r – 32v.

10 Pas gjase është ungji i tij Gjec Bardhi që ka luajtur rol kyç në formimin fetar-intelektual të Frangut, të cilit ai i shpreh falënderimet e rastit edhe në parathënien e fjalorit (1635 fol. 3v).

11 Për më shumë hollësi shih së fundi DEMIRAJ 2015 429v.

12 Shih edhe JURIĆ – KORADE 1982 74.

Shqip: "Frang Bardhi prej Zadrime në Shqipëri hyri në Kolegjin Ilirik (si) nëndiakon më 22 korrik 1628, në moshën 22 vjeç. U largua më 15 maj 1633 për të hyrë rishtas në Kolegjin e Propaganda Fide-s në Romë me vendim të Kongregacionit të Shenjtë të Propagandës për të studiuar teologji skolastike."

Në po këtë dokument (ASSC Tit. 30-32, fol 50v) mësojmë gjithashtu që Frang Bardhi i kurorëzoi, pas gjase, me sukses studimet në kolegjin në një hark kohor thuhetse katërvjeçar, duke fituar më dt. 4 dhjetor 1632 statusin e diakonit, të cilin ia akordoi Kard. Roma në Recanati (pranë Loreto-s), khs:

<Francesco Bianchi fu ordinato Diacono dal Sig.^r Cardinale Roma in Recanati le 4. tempora di Xbre 1632>¹³

Shqip: "Frang bardhi u rendua diakon prej z. Kard. Roma në Recanati në ditët e ordinacionit (= <quattro tempora>) të dhjetorit 1632."

3. Në Kolegjin Urban në Romë – shugurimi si prift dhe ipeshkëv

Vijimi i studimeve në Romë si nxënësi (= it. <Alunno>) i parë, i regjistruar në Kolegjin Urban të Propaganda Fide-s, është tregues më se i qartë edhe për mbarëvajtjen e formimit të patëmetë të Frangut tonë në kolegjin Ilirik të Loreto-s, anipse na mungojnë të dhënat dokumentare, sa i përket rezultateve konkrete të studimit të tij si në njërin ashtu edhe në tjetrin kolegjin. Ecurinë e studimit të tij dyvjeçar në Romë (12.06.1633 – 1.07.1635) e më pas betimin e tij si misionar apostolik i Propaganda Fide-s, sikurse edhe ngjitjen e njëhershme dyshkallëshe në hierarkinë e infrastrukturës klerikale katolike nëpërmjet shugurimit të tij të shpejtë si prift, e menjëherë pas tij, bash më 30 mars 1636, edhe si ipeshkëv i Sapës (dhe Sardës), e mësojmë thukët në regjistrin e nxënësve të Kolegjit Urban, të depozituar në ACU, në të cilin shkruhet sa vijon:

Francesco Bianchi di Soppa in Albania fu il 1^o Alunno ed fuisse
ricoverato in Collegio nella sua celtione, ed seguì il dì 12 giugno
1633: Ad p. 7 tra 1635 prestò il giuramento conforme la formula
prescritta: fu ordinato sacerdote et a dì 30 Marzo 1636 consecrato
Vescovo di Soppa dall'Em.^{mo} Sig.^{mo} Card. Rocca con l'assistenza
di Mons.^{gr} Fr. Batista Alveri Vescovo di Amerino, e di Mons.^{gr}
Vescovo d'Asi: Ad dì 3. d'Aprile se ne partì per la sua residenza.


Faksimile I: ACU Col. Urbano Registro vol. 1, f. 1.

13 Shih edhe JURIC – KORADE 1983 171.

<Francesco Bianchi di Sappa in Albania fu il p° alunno che fosse ricevuto in Collegio nella sua erezione, e seguì il dì 12 giugno 1633. A dì p° settembre 1635 prestò il giuramento conforme alla formula prescritta: fu ordinato Sacerdote et a dì 30 marzo 1636 consacrato Vescovo di Sappa dall'Em.mo Sig. Card. Roccia con l'assistenza di Monsig. Giov. Battista Altieri Vescovo di Camerino, e di Monsig. Vescovo d'Asti: a dì 3 d'aprile¹⁴ se ne partì per la sua residenza.>¹⁵

Shqip: "Frang Bardhi prej Sapës në Shqipëri qe i pari nxënës që u pranua në kolegji me themelimin e tij dhe filloi/ndoqi (studimet) më dt. 12 qershor 1633. Më dt. 1 shtator 1635 bëri betimin sipas formulës së paracaktuar: u shugurua prift dhe më dt. 30 mars 1636 u konsakrua ipeshkëv i Sapës prej Shkëlq. Z. Kardinal Roccia në prani të Imz. Giovanni Battista Altieri, ipeshkëv i Camerino-s dhe të Imz. ipeshkëv i Asti-t; më dt. 3 prill (1636) u nis për në selinë e tij (në Sapë)."

Këto të dhëna përsëriten në formë edhe më të përmbledhur në shtojcën e panumëruar në fund të regjistrit, si vijon:



Faksimile II: ACU Col. Urbano Registro vol. 1: shtojcë

<alunni all' aper|tura del Collegio 1: Francesco Bianchi di Sappa in Albania fu il 1.º | ricevuto in Collegio nella sua erezione che seguì il 12 | giugno [12. Giugno - sic!] 1633. \a terminati gli studi e fatto Sacerdote,/ ai 30. marzo 1636. consagrato Vesco.º di Sappa dall' Emmi. Card. Roccia col' assistenza di Mons. Giov. Batt. Altieri Ves.º di Camerino e di Monsig. Vescovo di Asti.>

Shqip: "Nxënës në hapjen e kolegjit: 1. Frang Bardhi prej Sapës në Shqipëri qe i pari nxënës që u pranua në kolegji me themelimin e tij që filloi/ndoqi (studimet) më dt. 12 qershor

¹⁴ ROQUES 1932a 25 (: "... et le 8 avril il partait.") shënon gabimisht si datë nisjeje 8 prillin.

¹⁵ Shih edhe JEZERNIK 1971 479.

1633; me t'i përfunduar u shugurua prift; më dt. 30 mars 1636 u konsakrua ipeshkëv i Sapës prej Shkëlq. Kard. Rocca-s në prani të Imz. Giov. Batt. Altieri, ipeshkëv i Camerino-s dhe të Imz. ipeshkëv të Asti-t."

Përfundim

Mbyllim këtu shkrimin tonë modest me synimin nismëtar për t'i përcjellë lexuesit të Hyllit tonë Dritës të dhëna të reja biografike me karakter kryesisht enciklopedik mbi Imz. Frang Mark Bardhin, të dhëna këto që kanë të bëjnë me trungun familjar dhe periudhën e formimit të tij fetar-intelektual si nxënës i Kolegjit Ilirik të Loretos e më pas të Kolegjit Urban të Propaganda Fide-s në Romë deri në konsakrimin e tij si ipeshkëv i Dioqezës së Sapës dhe Sardës dhe administrator apostolik i zonës së Pultit.

Materialet e reja arkivore që morëm në analizë tumirin dhe plotësojnë gjithashtu edhe të dhënat e sakta në studimin nismëtar të murgut filolog Mario Roques si ndër të parët studiues albanologë që nxitën mirëfilli studimet historiografike për kulturën e shkrimit shqip.¹⁶ Duke mbajtur parasysh të dhënat e reja të natyrës biografike që fituam gjatë analizës së këtyre materialeve, lejohemi të rindërtojmë tash me siguri deri diku absolute disa stacione në jetën dhe formimin fetar-intelektual të Frang Bardhit deri para fillimit të aktivitetit të tij baritor si ipeshkëv i Dioqezës së Sapës dhe Sardës (= shq. Shatit she Shurdhanit) në vitin 1936, sa vijon:

- a) Frang Bardhi (= lat. <Franciscus Blanchus> – B.D.) lindi në vitin 1606 në një fshat të Zadrimës, në familjen e Markut si pinjoll i fisit të madh e të njohur të Bardhenjve;
- b) Ungji i tij Imz. Gjergj/Gjec Bardhi (= <Monsig.^e Georgius Blancus>) u përkujdes për formimin e tij shkollor paraprak në vendlindje si nëndiakon, si edhe më pas për formimin e tij meshtarak në Kolegjin Ilirik të Loretës, ku Frang Bardhi regjistrohet më dt. 22 korrik 1628 dhe kryen një vit më vonë betimin kishtar më dt. 15 prill 1629;
- c) Frang Bardhi kryen studimet e rregullta në Loreto deri më dt. 15 maj 1633, duke fituar ndërkohë titullin meshtarak të diakonit, të cilin ia akordoi Kard. Roma në Recanati më dt. 4 dhjetor 1632;
- d) Më dt. 22 qershor 1633 Frang Bardhin e ndeshim në Kolegjin Urban të Propaganda Fide-s në Romë, ku vijon studimet e rregullta për teologji skolastike deri në vitin 1635, kur më dt. 1 shtator 1635 kryen betimin meshtarak, që u kërkohej rregullisht të

16 ROQUES 1932a/b.

gjithë nxënësve të Kolegjit Urban për t'u zotuar se do t'i dërgonin Kongregatës së Shenjtë të Propagandës çdo vit një relacion të hollësishëm lidhur me mbarëvajtjen e grigjës e përgjithësisht të jetës fetare në famullitë e dioqezat e vendlindjes, ku do të vepronin si klerikë.

- e) Pasi ishte shuguruar ndërkohë prift, Frang Bardhi konsakrohet më dt. 30 mars 1636 si ipeshkëv e Dioqezës së Sapës dhe Sardës dhe vizitor apostolik i zonës së Pultit në prani të Monsig.^e Giovanni Battista Altieri, ipeshkëv i Camerino-s dhe të ipeshkëvit të Asti-t;
- f) Më dt. 3 prill 1636 Frang Bardhi nisët përfundimisht për në selinë e tij në Dioqezën e Sapës dhe të Sardës, duke bërë një ndalesë në Venecia.

Bibliografi

1. Burimet

ACU – Archivio del Collegio Urbano (Roma).

ARSI – Archivio Romano della Società di Gesù (Roma)

ASSC – Archivio Storico della Sacra Casa (Loreto)

Bardhi, Frang [= <Franciscus Blanc(h)us>]

1635 Dictionarium latino – epiroticum. Una cum nonnullis usitatoribus loquendi formulis. Per R. D. Franciscum Blanchum Epirotam Coll. de Propag. Fide Alumnum. Romæ, Typis Sac. Congr. de Propag. Fide.

1636 Georgius Castriottus, Epirensis vulgò Scanderbegh, Epirotarum princeps fortissimus, ac iniuctissimus Suis, & Patriae restitutus. Per Franciscum Blancum. De Alumnis, Collegij de Propaganda Fide, Episcopum Sappatensem & Sardanensem, necnon Pulatensium, aliorumque Albaniae Populorum Administratorem. – Venetiis. Typis Marci Ginammi. MDCXXXVI

2. Literaturë shkencore

Farlati, Daniele & Coleti, Jacopo

1817: Illyricum sacrum, t. VII. Venetiis.

Demiraj, Bardhyl

2008 (botues) Dictionarium latino – epiroticum. Una cum nonnullis usitatoribus loquendi formulis. Per R. D. Franciscum Blanchum Epirotam Coll. de Propag.

Fide Alumnum. Romæ, Typis Sac. Congr. de Propag.
Fide. 1635 (Botim kritik – përgatiti Bardhyl Demiraj).
Shkodër.

- 2014 Jetë rishtarësh shqiptarë në Kolegjin Ilirik të Feros
(1663 - 1746), në : "Hylli i Dritës" nr. 3-4, f. 425-446.
Shkodër.

Jezernik, Maximiljan

- 1971 Il Collegio Urbano, në: "Sacrae Congregationis de
Propaganda Fide Memoria Rerum", Cap III, Vol. I/1 1622 -
1700, f. 465-482. Rom – Freiburg – Wien.

Jurić, J. – Korade, Mijo

- 1982 Iz arhivske gradje o ilirskom kolegiju u Loretu, parte I, në:
"Vrela i prinosi" nr. 13, f. 61-105
1983 Iz arhivske gradje o ilirskom kolegiju u Loretu, parte II,
në: "Vrela i prinosi" nr. 14, f. 155-203.

Roques, Mario

- 1932a Le Dictionnaire albanais de 1635, édité avec introduction
et index complet (par M. Roques). Dictionarium latino-
epiroticum per R. D. Franciscum Blanchum, Paris.
1932b: Recherches sur les anciens textes albanais, Paris.

Bardhyl Demiraj

New Biographical Notes about our Old Albanian Authors

I. Frang Mark Bardhi (1606 - 1643)

Summary

In this study the author brings new biographical data about Archbishop Frang Mark Bardhi (= <Franciscus Marcus Blanchus>), in regard on his family tree and the period of his religious-intellectual education as a student in the Illyrian College in Loreto, afterwards in the Urban College of Propaganda Fide in Rome, up to his consecration as bishop of the Sapa and Sarda Dioceses and apostolic administrator of the Pulti area. New archival materials complement with new evidence the accurate data of the initial study of Mario Roques (1932b) as one of the first scholars that genuinely encouraged the historiographical studies on the Albanian writing culture.